

Forumi i Tetë Rajonal për Prokurimin Publik, 22 – 25 Maj, 2012, Tiranë

Në datat 22-25 Maj, 2012, u zhvillua në Tiranë Forumi i Tetë Rajonal për Prokurimin Publik, i bashkëfinancuar nga Banka Botërore, Banka Aziatike për Zhvillim, Banka Islamike për Zhvillim dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Duke patur në konsideratë suksesin e deritanishëm të aplikimit të sistemit të prokurimit elektronik në Shqipëri, si dhe me qëllim shkëmbimin e kësaj eksperience ndërmjet vendeve pjesëmarrëse, fokusi i këtij forumi ishte Prokurimi Elektronik –Një hap i madh në drejtim të transparencës.

Në këtë forum për prokurimin publik, i cili është një event i përvitshëm dhe që zhvillohet për herë të parë në Shqipëri, morën pjesë rreth 75 persona, ndërmjet të cilëve edhe përfaqësues të lartë të donatorëve dhe vendeve pjesëmarrëse në forum.

Në ditën e parë të forumit, dhe konkretisht në sesionin e hapjes së tij, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, z. Genc Pollo, dhe Drejtoresha e Agjencisë së Prokurimit Publik, znj. Klodiana Cankja, si përfaqësues të palës Shqiptare, mirëpritën pjesëmarrësit dhe prezantuan sfidat dhe arritjet e Qeverisë Shqiptare përkatësisht gjatë krijimit dhe zbatimit të sistemit të prokurimit elektronik në vend.

Gjatë forumit, përfaqësuesit e vendeve të pranishme paraqitën reformat në sistemet e tyre të prokurimit publik, dhe planet për të ardhmen. Gjithashtu, të ftuar nga institucionet rregullatore të prokurimeve nga Italia, Portugalia, UNCITRAL, SIGMA prezantuan përjashtet e tyre mbi tematika me rëndësi për fushën e prokurimeve, si Marrëveshjet Kuadër, prokurimi i përqëndruar, zbatimi i

prokurimit elektronik dhe zhvillimi i një kuadri ligjor që rrit avantazhet e përdorimit të tij.

Prezantime mbi politikat dhe praktikat e tyre për prokurimin publik dhe vlerësime për sistemet e vendeve ku ata operojnë, mbajtën edhe përfaqësues të donatorëve, të cilët theksuan arritjet e Shqipërisë në drejtim të sistemit të prokurimit publik, dhe në veçanti të atij elektronik. Përfaqësues të Bankës Botërore përmendën progresin e arritur së fundmi nga Shqipëria në këtë fushë, kryesisht në drejtim të transparencës së sistemit, si aksesimi i përmirësuar publik për çdo informacion në lidhje me prokurimet, publikimi i të gjitha njoftimeve të prokurimit dhe kontratave përkatëse në faqen zyrtare të Internetit të APP-së, ndryshimet në ligjin e prokurimit publik, si dhe marrëveshjen ndërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Bankës Botërore për përdorimin e sistemit elektronik në kryerjen e procedurave të Bankës. Për më tepër, u përmend edhe kryerja e një procedure pilot të Bankës në sistemin Shqiptar të prokurimit elektronik bashkë me avantazhet e përdorimit të këtij të fundit.

Përfaqësues të Bankës Botërore evidentuan progresin e reformave në prokurimin publik në Shqipëri, duke krahasuar studimet e vlerësimit mbi bazën e metodologjisë OECD – DAC, realizuar nga ekspertë të huaj, përkatësisht në vitet 2006 dhe 2010.

Rasti i sistemit Shqiptar për prokurimin publik me reformat ligjore dhe rregullatore u prezantua nga përfaqësues të OECD edhe gjatë Forumit të Nivelit të Lartë mbi Efektshmërinë e Ndihmës, të mbajtur në Nëntor 2011, Busan, Kore, si “best practice” (dokumenti gjendet në adresën:

http://siteresources.worldbank.org/INTALBANIA/Resources/Strengthening_Procurement_Systems.pdf).

Gjithashtu, nga përfaqësues në forum të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, sipas raportit të vlerësimit të kësaj të fundit të kryer në vitin 2010, Shqipëria ishte një ndër vendet e rajonit ku Banka operon, e cilësuar si rast i suksesshëm i zbatimit të prokurimit elektronik dhe reformave në fushën e prokurimeve publike. Ky raport gjendet në adresën elektronike:

<http://www.ebrd.com/downloads/legal/procurement/ppreport.pdf>.

Si rezultat i shkëmbimit të eksperiencave ndërmjet vendeve dhe organizmave ndërkombëtarë pjesëmarrës në forum, mbi funksionimin e sistemeve të prokurimit publik, e konsiderojmë këtë event të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të praktikave të prokurimit dhe integritetit të procesit.

Në përfundim, të gjithë pjesëmarrësit diskutuan mbi planin e veprimit në kuadër të reformave të prokurimit publik, që çdo vend parashikon të realizojë deri vitin e ardhshëm.